

VENDIM
Nr. 120, datë 5.3.2020

PËR MIRATIMIN E “FORMULARIT TË INTEGRUAR TË VLERËSIMIT TË GJYQTARIT”

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenin 147, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës, nenet 2, 68–72, 74–78, 84–95, 97 dhe 171, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, datë 21.11.2019 “Rregulla plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 264, datë 19.12.2019 “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale

VENDOSI:

1. Miratimin e “Formularit të integruar të vlerësimit të gjyqtarit”, sipas formatit bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 2. “Formulari i integruar i vlerësimit të gjyqtarit” hartohet në format shkresor dhe/ose elektronik, të cilët kanë vlerë të njëjtë.
- Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETARE
Naureda Llagami

FORMULAR I INTEGRUAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARIT

Për periudhën 20__ - 20 __

TË DHËNAT E GJYQTARIT	TË DHËNAT E KRYETARIT
Emri:	Emri:
Mbiemri:	Mbiemri:
Datëlindja:	Datëlindja:
Vendbanimi:	Vendbanimi:
Adresa e e-mail-it zyrtar:	Adresa e e-mail-it zyrtar:
Adresa e e-mail-it privat:	Adresa e e-mail-it privat:
Numër telefoni:	Numër telefoni:
Gjykata:	Gjykata:
Funksioni:	Funksioni:

Formulari i integruar i vlerësimit dhe hapat për plotësimin e tij

1. Ky formular vlerësimi ka të integruar në përmbajtjen e tij vetëvlerësimin e gjyqtarit dhe mendimin përfundimtar të Kryetarit, prandaj titullohet “Formular i integruar i vlerësimit të gjyqtarit”.

2. Ky formular është pjesë e akteve të vlerësimit dhe përbën burim vlerësimi në kuptim të nenit 77, shkronjat “ç” dhe “d”, të ligjit për statusin.

3. Formulari i integruar i vlerësimit, plotësohet nga gjyqtari në zbatim të nenit 86, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji për statusin) dhe nga Kryetari, në rubrikat përkatëse, në zbatim të nenit 87, të ligjit për statusin.

4. Gjyqtari plotëson formularin e vlerësimit, në rubrikat përkatëse të caktuara për të dhe ia dorëzon kryetarit të gjykatës ku gjyqtari ka ushtruar funksionin gjatë periudhës së vlerësimit, brenda 3 javëve nga marrja e njoftimit të vendimit të Këshillit për fillimin e procesit të vlerësimit etiko-profesional.

5. Kryetari i gjykatës, ku gjyqtari ka ushtruar detyrën gjatë periudhës së vlerësimit, jep mendimin paraprak, duke plotësuar rubrikën e këtij formulari të emërtuar “Mendimi paraprak i Kryetarit” dhe ia njofton atë gjyqtarit, jo më vonë se katër javë nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procesit të vlerësimit etiko-profesional. Brenda tri ditëve nga njoftimi i mendimit paraprak, gjyqtari mund të ushtrojë të drejtën për t’u dëgjuar dhe paraqet kërkesë për zhvillimin e një takimi me kryetarin.

6. Pas realizimit të dëgjësës me gjyqtarin sipas procedurës së parashikuar në nenin 87, të ligjit për statusin, Kryetari jep mendimin përfundimtar në lidhje me veprimtarinë e gjyqtarit, duke plotësuar rubrikën e këtij formulari të emërtuar “Mendimi përfundimtar i Kryetarit”.

7. Në rast se në momentin e fillimit të procesit të vlerësimit etik-profesional, kompetencat e Kryetarit ushtrohen nga zëvendëskryetari, në referim të parashikimeve të nenit 26, pika 2, të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, formulari i mendimit përfundimtar të kryetarit plotësohet nga zëvendëskryetari.

8. Në rast se gjatë periudhës së vlerësimit, gjyqtari që vlerësohet, ka ushtruar detyrën në më shumë se një gjykatë, formulari i integruar i vlerësimit plotësohet nga gjyqtari dhe kryetari i secilës gjykatë, për periudhën përkatëse.

9. Në rastin kur gjyqtari që vlerësohet ushtron funksionet e kryetarit të gjykatës, formulari i integruar i vlerësimit, plotësohet nga gjyqtari vetëm për rubrikat e vetëvlerësimit, ndërsa rubrikat e “mendimit të kryetarit” mbeten të paplotësuara.

10. Formulari i integruar i vlerësimit të gjyqtarit përmban, veç mendimit të kryetarit (paraprak dhe përfundimtar), edhe kundërshtimet e mundshme të gjyqtarit për secilin nga kriteret, aspektet dhe treguesit e vlerësimit.

11. Formulari plotësohet në mënyrë elektronike dhe nënshkruhet nga gjyqtari dhe kryetari.

12. Formularit i bashkëngjiten dy vendime të përzgjedhura prej gjyqtarit për secilin vit vlerësimi, si dhe dokumente që tregojnë angazhimin në veprimtaritë profesionale ndërinstitucionale gjatë periudhës së vlerësimit, trajnimet jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës dhe çdo dokument tjetër që evidenton veprimtarinë profesionale. Dokumentet për trajnimet jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës duhet të evidentojnë përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e trajnimit, si dhe të dhëna për institucionin që ka organizuar aktivitetin.

13. Pas realizimit të procedurës së parashikuar nga neni 87 i ligjit për statusin, por jo më vonë se 2 muaj nga marrja e njoftimit të vendimit të Këshillit për fillimin e procesit të vlerësimit etiko-profesional të gjyqtarit, kryetari dërgon pranë Këshillit në format elektronik dhe shkresor, formularin e integruar të vlerësimit të gjyqtarit bashkë me aktet e vlerësimit të përcaktuara në nenin 88 pika 2 të ligjit për statusin.

Vetëvlerësimi i gjyqtarit në zbatim të nenit 86 të ligjit për statusin.

14. Gjyqtari vetëvlerësohet sipas katër grup kriterëve të vlerësimit të parashikuara në ligjin për statusin, duke përzgjedhur vetëm njërën nga shkallët e aftësisë për çdo tregues vlerësimi.

15. Gjyqtari bën vetëvlerësimin e aftësive organizative duke përzgjedhur shkallën e aftësisë për çdo tregues vlerësimi mbi bazën e një analize të pavarur të të dhënave të tij statistikore, referuar tabelave statistikore që i janë vënë në dispozicion para fillimit të procesit të vlerësimit.

16. Gjyqtari ka të drejtë të japë shpjegime dhe të argumentojë vetëvlerësimin e tij. Në pjesët e formularit dedikuar shpjegimeve, gjyqtari parashtrohet të dhënat, kushtet faktike dhe arsyet që sipas tij/saj justifikojnë një shkallë më të lartë aftësie se ajo që rezulton nga të dhënat statistikore.

Mendimi i kryetarit, në zbatim të nenit 87, pika 1, të ligjit për statusin, bazohet në standardet e mëposhtme:

17. Kryetari nuk jep mendim për kriterin e aftësisë profesionale të gjyqtarit.

18. Në mendimin e kryetarit përshkruhet dhe vlerësohet veprimtaria e gjyqtarit sipas tri grup-kritereve të vlerësimit të parashikuara në ligjin për statusin, konkretisht për:

- “Aftësitë organizative”;
- “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”; dhe
- “Aftësitë personale dhe angazhimin profesional”.

i. Për kriterin e “Aftësisë organizative” kryetari jep mendim dhe vlerëson gjyqtarin për:

- Aftësinë e përballjes së ngarkesës në punë, e vlerësuar nëpërmjet:

- a) respektimit të afateve ligjore;
- b) plotësimin e standardeve minimale kohore;
- c) kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje;
- d) rendimentit të përfundimit të çështjeve;
- e) kohës mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar.

- Aftësinë për të kryer procedura gjyqësore, e vlerësuar nëpërmjet:

a) numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive;

- b) kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor;

ii. Për kriterin e “Etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale”, kryetari jep mendim dhe vlerëson gjyqtarin, për:

- etikën në punë të gjyqtarit e vlerësuar nëpërmjet angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion;

- integritetin e gjyqtarit, i vlerësuar nëpërmjet shmangies së shfaqjeve të pahijshme dhe transmetimit nga gjyqtari të vlerave të tilla personale dhe profesionale si nderi dhe dinjiteti;

- paanësisë në funksion, e vlerësuar kjo nëpërmjet “numrit tejet të lartë ose të pakonsiderueshëm” të kërkesave të pranuar për përjashtim gjyqtari;

iii. për kriterin e “Aftësisë personale dhe angazhimit profesionale”, kryetari jep mendim dhe vlerëson gjyqtarin për:

- Aftësinë e komunikimit të gjyqtarit e vlerësuar nëpërmjet:

- a) komunikimit të qartë dhe transparent;
- b) respektimit të konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

- Aftësinë për të bashkëpunuar, e vlerësuar nëpërmjet:

a) shkallës së komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta;

- b) shkallës së komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore.

- Gatishmërinë e gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera, e vlerësuar nëpërmjet:

a) pjesëmarrjes së gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun të gjykatave.

19. Mendimi përfundimtar i kryetarit jepet duke u bazuar në nivelet e vlerësimit të parashikuara në nenin 78 të ligjit për statusin, duke përzgjedhur vetëm njërën nga shkallët e aftësisë për çdo tregues vlerësimi. Kryetari duhet të japë shpjegime dhe të argumentojë mendimin

e tij, veçanërisht për ato kritere për të cilat mendimi i tij përfundimtar, ndryshon nga vëtvlerësimi i kryer nga gjyqtari.

20. Kryetari vlerëson aftësitë organizative të gjyqtarit duke përzgjedhur shkallën e aftësisë për çdo tregues vlerësimi, mbi bazën e analizës së të dhënave statistikore të veprimtarisë së gjyqtarit, duke i krahasuar ato me treguesit mesatarë statistikore të gjykatës, për të njëjtën kategori çështjesh, brenda të njëjtit seksion (nëse gjykata ka pasur të tillë), në të njëjtën periudhë kohore.

21. Kryetari jep mendim për treguesin “rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore”, duke bërë krahasimin e rendimentit të gjyqtarit, me treguesin mesatar statistikor të gjykatës për këtë tregues gjatë periudhës së vlerësimit (rendimentin e përfundimit të çështjeve në gjykatë), si dhe krahasimin e numrit total të çështjeve që ka gjykuar ky gjyqtar me numrin e përgjithshëm të çështjeve të gjykuara në gjykatë.

22. Kryetari jep mendim për shkallën e aftësisë së gjyqtarit në shmangien e seancave gjyqësore joproduktive duke bërë krahasimin jo vetëm me treguesin mesatar statistikor të gjykatës për numrin mesatar të seancave gjyqësore sipas kategorisë së çështjes, por dhe në referim të përqindjes totale të çështjeve të përfunduara nga gjyqtari brenda afatit ligjor dhe standardit minimal.

23. Kryetari jep mendim për shkallën e aftësisë së gjyqtarit në organizimin e procesit gjyqësor, bazuar në të dhëna objektive të konstatuara prej tij, pa qenë i nevojshëm hulumtimi mbi çdo dosje gjyqësore të gjyqtarit.

24. Kryetari jep mendim për etikën, integritetin dhe paanësinë e gjyqtarit, bazuar mbi prezumimin se gjyqtari i ka këto cilësi. Kryetari parashtrohet dhe jep mendim për problematika të shfaqura nga gjyqtari, të tilla që duhet të merren parasysh në vlerësim.

25. Kryetari jep mendim nëse numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtim gjyqtari është “tejet i lartë” ose “i pakonsiderueshëm”, jo vetëm në aspektin sasior, apo krahasuar me numrin total të çështjeve të gjykuara nga gjyqtari. Kryetari duhet të marrë në konsideratë numrin e kërkesave për heqje dorë të paraqitura nga gjyqtari si dhe raportin midis kërkesave për heqje dorë të miratuara me ato të refuzuara. Kryetari jep mendim për këtë tregues, pa analizuar ligjshmërinë ose bazueshmërinë e vendimit të pranimit të kërkesës për përjashtim.

26. Kryetari jep mendim për treguesin e “gatishmërinë e gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera” në rastet kur ai është në dijeni të angazhimit të gjyqtarit, apo kur ky angazhim ka qenë i iniciuar nga vetë kryetari i Gjykatës.

VLERËSIMI PËRKUNDREJT KRITEREVE VLERËSUESE

1. Vlerësimi i aftësive profesionale të gjyqtarit

Me anë të kriterit të aftësisë profesionale të gjyqtarit vlerësohet aftësia e gjyqtarit në drejtim të njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor.

1. A Njohuritë ligjore

1.A-a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të përcaktuar faktet e çështjes, identifikuar natyrën e saj, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave sipas rastit.

Si e vlerëson gjyqtari shkallën e aftësisë së tij?

E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐
----------------------------------	--	-----------------------------------	--	--

Shpjegime (Këtu gjyqtari duhet të japë shpjegime referuar veprimtarisë së tij profesionale gjatë periudhës së vlerësimit dhe vendimeve të përzgjedhura prej tij)

1.A-b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të interpretuar ligjin e identifikuar dhe arsyetimi i tij për mënyrën e zbatimit të ligjit mbi faktet objekt gjykimi. Vlerësohet gjithashtu aftësia në zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës materiale dhe procedurale që kanë lidhje me interpretimin e ligjit dhe zgjidhjen e çështjes, aftësia për të kërkuar, identifikuar, organizuar dhe përdorur jurisprudencën relevante vendase dhe ndërkombëtare, referimi dhe menaxhimi me efikasitet, në vendin e duhur dhe sipas llojit të qëllimit të aktit në praktikën e konsoliduar gjyqësore, praktikën e unifikuar/njësuar të Gjykatës së Lartë, praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, GJEDNJ-ja dhe gjithë jurisprudencën, edhe në rastet kur ajo nuk përbën burim të së drejtës po i shërben interpretimit të ligjit në kuadër të përafrimit të legjislacionit.

Si e vlerëson gjyqtari shkallën e aftësisë së tij?

E dobët ☐

Nën mesataren ☐

Mesatare ☐

Mbi mesataren ☐

Shumë e lartë ☐

Shpjegime (Këtu gjyqtari duhet të japë shpjegime referuar veprimtarisë së tij profesionale gjatë periudhës së vlerësimit dhe vendimeve të përzgjedhura prej tij)

1.B Arsyetimi ligjor.

1.B-a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të përdorur thjesht dhe drejtpërdrejt gjuhën shqipe, aftësia për të shprehur mendimin qartë dhe me sa më pak fjalë, zbatimi i saktë i rregullave gramatikore dhe atyre të sintaksës, përzgjedhja e kujdesshme e gjuhës dhe përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (ë dhe ç), organizimi i paragrafëve dhe i strukturës së fjalisë për të shprehur kuptimin, përdorimi në mënyrë korrekte dhe konsistente i termave teknikë.

Si e vlerëson gjyqtari shkallën e aftësisë së tij?

E dobët ☐

Nën mesataren ☐

Mesatare ☐

Mbi mesataren ☐

Shume e lartë ☐

Shpjegime (Këtu gjyqtari duhet të japë shpjegime referuar veprimtarisë së tij profesionale gjatë periudhës së vlerësimit dhe vendimeve të përzgjedhura prej tij)

1.B-b Struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e vendimit.

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të hartuar vendimin sipas një strukture të qartë, të qëndrueshme, të mirorganizuar, të cilës gjyqtari i përmbahet me përpikëri gjatë prezantimit të fakteve, në identifikimin e ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Në veçanti, vlerësohet ndjekja e një metodologjie të caktuar sipas pjesëve përbërëse të vendimit, në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së tij.

Si e vlerëson gjyqtari shkallën e aftësisë së tij?

E dobët ☐

Nën mesataren ☐

Mesatare ☐

Mbi mesataren ☐

Shume e lartë ☐

Shpjegime (Këtu gjyqtari duhet të japë shpjegime referuar veprimtarisë së tij profesionale gjatë periudhës së vlerësimit dhe vendimeve të përzgjedhura prej tij)

1.B-c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e gjyqtarit për kryer një analizë cilësore, mbi bazën e një zhvillimi logjik të koncepteve ligjore. Argumentimi logjik nënkupton aftësinë e gjyqtarit për të

identifikuar marrëdhëniet shkak-pasojë, si edhe për të analizuar se si konceptet, institutet dhe dispozitat lidhen midis tyre, ose se si ato zbatohen në një situatë të caktuar. Në veçanti, vlerësohet nëse niveli i arsytimit plotëson standardin e procesit të rregullt ligjor dhe nëse përmbajtja është gjithëpërfshirëse, duke u dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të palëve.

Si e vlerëson gjyqtari shkallën e aftësisë së tij?

E dobët ☐

Nën mesataren ☐

Mesatare ☐

Mbi mesataren ☐

Shumë e lartë ☐

Shpjegime (Këtu gjyqtari duhet të japë shpjegime referuar veprimtarisë së tij profesionale gjatë periudhës së vlerësimit dhe vendimeve të përzgjedhura prej tij)

2. Vlerësimi i aftësive organizative të gjyqtarit.

Me anë të kriterit të aftësive organizative vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të përballuar ngarkesën në punë, aftësia për të organizuar, administruar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore, aftësia e menaxhimit efektiv të kohës si në planifikimin e seancave gjyqësore ashtu edhe në veprimet procedurale jashtë tyre, si dhe aftësia për të administruar dosjen gjyqësore.

2.A Aftësia e gjyqtarit për të përballuar ngarkesën në punë.

2.A-a Respektimi i afateve ligjore

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e gjyqtarit për respektimin e afateve të parashikuara nga ligji brenda të cilave duhet të përfundojë gjykimi i çështjeve, sipas kategorive. Vlerësimi bëhet referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkallim të afatit ligjor, me numrin total të çështjeve të gjykuara, për të cilat ligji parashikon këtë afat.

Gjyqtari bën një analizë të pavarur të të dhënave të tij statistikore dhe përzgjedh shkallën e aftësisë së tij.

E dobët ☐
(mbi 40%)

Nën mesataren ☐
(31-40%)

Mesatare ☐
(21-30%)

Mbi mesataren ☐
(11-20%)

Shumë e lartë ☐
(0-10%)

Shpjegime (Këtu gjyqtari mund të japë shpjegime mbi situatën faktike lidhur me kompleksitetin e çështjeve, volumin e tyre, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, si dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të justifikojnë një pikëzim më të lartë referuar “Metodologjisë së Pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, miratuar me vendimin e KLGJ-së nr. 264, datë 21.11.2019, deri në pikëzim maksimal)

Mendimi paraprak i kryetarit (Bazuar në analizën e të dhënave statistikore të gjyqtarit, Kryetari duhet të japë mendimin e tij paraprak mbi shkallën e aftësisë së gjyqtarit, duke bërë krahasimin me treguesin mesatar statistikor të gjykatës gjatë periudhës së vlerësimit, për këtë tregues)

E dobët ☐

Nën mesataren ☐

Mesatare ☐

Mbi mesatare ☐

Shumë e lartë ☐

Ka pasur kundërshtime të gjyqtarit?

Po ☐ (nëse po duhet të pasqyrohen se cilat kanë qenë ato)

Jo ☐

Mendimi përfundimtar i kryetarit (Këtu Kryetari jep mendimin përfundimtar dhe përcakton shkallën e aftësisë, pas realizimit të dëgjësës me gjyqtarin)

E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐
----------------------------------	--	-----------------------------------	--	--

2.A-b Plotësimi i standardeve minimale kohore.

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të respektuar afatet orientuese të miratuara për çdo kategori çështjesh, referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të standardit minimal kohor, me numrin total të çështjeve të gjykuara. Në numrin total të çështjeve të gjykuara nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen afate gjykimi.

Gjyqtari bën analizën e pavarur të të dhënave të tij statistikore dhe përzgjedh shkallën e aftësisë së tij.

E dobët ☐ (mbi 40%)	Nën mesataren ☐ (mbi 30-40%)	Mesatare ☐ (mbi 20-30%)	Mbi mesataren ☐ (mbi 10-20%)	Shumë e lartë ☐ (0-10%)
---	--	---	--	---

Shpjegime (Këtu gjyqtari mund të japë shpjegime mbi situatën faktike lidhur me kompleksitetin e çështjeve, volumin e tyre, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, si dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të justifikojnë një pikëzim më të lartë referuar “Metodologjisë së Pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, miratuar me vendimin e KLGJ-së nr. 264, datë 21.11.2019, deri në pikëzim maksimal)

Mendimi paraprak i kryetarit (Bazuar në analizën e të dhënave statistikore të gjyqtarit Kryetari duhet të japë mendimin e tij paraprak mbi shkallën e aftësisë së gjyqtarit, duke bërë krahasimin me treguesin mesatar statistikor të gjykatës, për këtë tregues)

E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐
----------------------------------	--	-----------------------------------	--	--

Ka pasur kundërshtime të gjyqtarit?

Po ☐ (nëse po duhet të pasqyrohen se cilat kanë qenë ato)

Jo ☐

Mendimi përfundimtar i kryetarit (Këtu Kryetari jep mendimin përfundimtar dhe përcakton shkallën e aftësisë, pas realizimit të dëgjësës me gjyqtarin)

E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☒	Shumë e lartë ☐
----------------------------------	--	-----------------------------------	---	--

2.A-c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të përfunduar çështjet në afat, sipas kategorisë përkatëse, në raport me standardet minimale kohore të miratuara, për çdo kategori. Në totalin e çështjeve të gjykuara nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen afate ligjore gjykimi.

Gjyqtari bën analizën e pavarur të të dhënave të tij statistikore dhe përzgjedh shkallën e aftësisë së tij. Ai përzgjedh një nga nivelet e mëposhtme pas krahasimit me standardet e miratuara.

E dobët ☐ (Më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve)	Nën mesataren ☐ (Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve)	Mesatare ☐ (Më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve)	Mbi mesataren ☐ (Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve)	Shumë e lartë ☐ (Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve)
--	--	--	---	--

Shpjegime (Këtu gjyqtari mund të japë shpjegime mbi situatën faktike lidhur me kompleksitetin e çështjeve, volumin e tyre, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, si dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të justifikojnë një pikëzim më të lartë referuar “Metodologjisë së Pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, miratuar me vendimin e KLGJ-së nr. 264 datë 21.11.2019, deri në pikëzim maksimal)

Mendimi paraprak i kryetarit (Bazuar në analizën e të dhënave statistikore të gjyqtarit Kryetari duhet të japë mendimin e tij paraprak mbi shkallën e aftësisë së gjyqtarit, duke bërë krahasimin me treguesin mesatar statistikor të gjykatës, për këtë tregues)				
E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐
Ka pasur kundërshtime të gjyqtarit?				
Po ☐ (nëse po duhet të pasqyrohen se cilat kanë qenë ato)				
Jo ☐				
Mendimi përfundimtar i kryetarit (Këtu Kryetari jep mendimin përfundimtar dhe përcakton shkallën e aftësisë, pas realizimit të dëgjësës me gjyqtarin)				
E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐

2.A-ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e gjyqtarit për përfundimin e çështjeve gjyqësore, duke iu referuar raportit të numrit të çështjeve të përfunduara nga gjyqtari, pavarësisht kohës së caktimit të tyre, me numrin e çështjeve që i janë caktuar brenda një viti kalendarik.

Gjyqtari bën analizën e pavarur të të dhënave të tij statistikore dhe përzgjedh shkallën e aftësisë së tij.

E dobët ☐ (nën 81%)	Nën mesataren ☐ (mbi 81–87%)	Mesatare ☐ (mbi 87–93%)	Mbi mesataren ☐ (mbi 93–99%)	Shumë e lartë ☐ (mbi 99%)
---	--	---	--	---

Shpjegime (Këtu gjyqtari mund të japë shpjegime mbi situatën faktike lidhur me kompleksitetin e çështjeve, volumin e tyre, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, si dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të justifikojnë një pikëzim më të lartë, referuar “Metodologjisë së Pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, miratuar me vendimin e KLGJ-së nr. 264, datë 21.11.2019, deri në pikëzimin maksimal, nëse gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit viti kalendarik më shumë se 50% të standardit minimal të ngarkesës të miratuar.)

Mendimi paraprak i kryetarit (Bazuar në analizën e të dhënave statistikore të gjyqtarit Kryetari duhet të japë mendimin e tij paraprak mbi shkallën e aftësisë së gjyqtarit, duke bërë krahasimin e rendimentit të gjyqtarit me treguesin mesatar statistikor të gjykatës për këtë tregues (rendimenti i gjykatës) si dhe krahasimin e numrit total të çështjeve që ka gjykuar ky gjyqtar me numrin e përgjithshëm të çështjeve të gjykuara në atë gjykatë)

E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐
Ka pasur kundërshtime të gjyqtarit?				
Po ☐ (nëse po duhet të pasqyrohen se cilat kanë qenë ato)				
Jo ☐				

Mendimi përfundimtar i kryetarit (Këtu Kryetari jep mendimin përfundimtar dhe përcakton shkallën e aftësisë, pas realizimit të dëgjësës me gjyqtarin)

E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐
----------------------------------	--	-----------------------------------	--	--

2.A-d Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të arsyetuar në kohë sa më të shpejtë vendimet gjyqësore. Treguesi mesatar i kohës së arsyetimit për të gjitha vendimet gjyqësore të dhëna nga gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit, llogaritet nga data e dhënies së vendimit deri në datën e dorëzimit të vendimit, tregues i cili krahasohet me afatin procedural të parashikuar në ligj.

Gjyqtari bën analizën e pavarur të të dhënave të tij statistikore dhe përcakton shkallën e aftësisë së tij. Ai përzgjedh një nga nivelet e mëposhtme pas krahasimit me afatin procedural të parashikuar në ligj.

E dobët ☐ (Më e gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve) ☐	Nën mesataren ☐ (Më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve) ☐	Mesatare ☐ (Më e gjatë se afati procedural për gjysmën e kategorive të çështjeve) ☐	Mbi mesataren ☐ (Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve) ☐	Shumë e lartë ☐ (Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve) ☐
Shpjegime (Këtu gjyqtari mund të japë shpjegime mbi situatën faktike lidhur me kompleksitetin e çështjeve, volumin e tyre, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, si dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të justifikojnë një pikëzim më të lartë referuar “Metodologjisë së Pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, miratuar me vendimin e KLGJ-së nr. 264, datë 21.11.2019, duke zbatuar një koeficient jo më shumë se 20%)				
Mendimi paraprak i kryetarit (Bazuar në analizën e të dhënave statistikore të gjyqtarit Kryetari duhet të japë mendimin e tij paraprak mbi shkallën e aftësisë së gjyqtarit, duke bërë krahasimin me treguesin mesatar statistikor të gjykatës për këtë tregues)				
E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐
Ka pasur kundërshtime të gjyqtarit?				
Po ☐ (nëse po duhet të pasqyrohen se cilat kanë qenë ato)				
Jo ☐				
Mendimi përfundimtar i kryetarit (Këtu Kryetari jep mendimin përfundimtar dhe përcakton shkallën e aftësisë, pas realizimit të dëgjësës me gjyqtarin)				
E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐

2.B Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedurat gjyqësore

2.B-a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive.

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e gjyqtarit për kryerjen e procedurave gjyqësore efektive për çdo kategori çështjesh (civile, administrative, penale, dhe sipas shkallëve të gjykimit), duke përjashtuar ato pa palë ndërgjyqëse, si dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive. Vlerësohet eficientia e gjyqtarit për kryerjen e veprimeve të tilla si: mbikëqyrja e dërgimit pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit; marrja e masave për të siguruar njoftime të rregullta për seancat pasardhëse; planifikimi i seancave, duke marrë parasysh kohëzgjatjen e çështjes, afatet ligjore, dhe mendimin e palëve si dhe çdo masë tjetër e marrë konkretisht nga gjyqtari për shmangien e seancave joproduktive.

Gjyqtari bën analizën e pavarur të të dhënave të tij statistikore dhe përcakton numrin mesatar të seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh, nëse kjo e dhënë është pjesë e tabelave statistikore. Ai vetëvlerëson aftësinë në kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave gjyqësore joproduktive dhe përzgjedh një nga nivelet e mëposhtme të vlerësimit.

(Sipas metodologjisë së miratuar dhe nenit 171, pika 9, e ligjit për statusin, treguesi i numrit mesatar të seancave për çështje bëhet pjesë e vlerësimit etik dhe profesional kur statistikën mundësohen në rrugë elektronike. Nëse kjo nuk është e mundur, ky tregues për vlerësimin dhe zvarritjen e gjykimeve, do të identifikohet dhe analizohet nga vlerësuesi vetëm për çështjet e zgjedhura me short)

E dobët ☐	Mesatare ☐	E lartë ☐
Mbi 3 seanca dhe shkallë e dobët aftësie	Mbi 3 seanca dhe shkallë mesatare aftësie	1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë aftësie
Shpjegime (Këtu gjyqtari mund të japë shpjegime mbi situatën faktike lidhur me kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, si dhe në kujdesin që tregon gjyqtari për shmangien e seancave gjyqësore joproduktive)		
Mendimi paraprak i kryetarit (Bazuar në analizën e të dhënave statistikore të gjyqtarit Kryetari duhet të japë mendimin e tij paraprak mbi shkallën e aftësisë së gjyqtarit, duke bërë krahasimin me treguesin mesatar statistikor të gjykatës për këtë tregues. Këtu kryetari duhet të japë mendimin e tij paraprak mbi shkallën e aftësisë së gjyqtarit, duke bërë krahasimin jo vetëm me treguesin mesatar statistikor të gjykatës për këtë indikator (për numrin e seancave), por dhe në referim të përqindjes totale të çështjeve të përfunduara nga gjyqtari brenda afatit ligjor dhe standardit minimal.)		
E dobët ☐	Mesatare ☐	E lartë ☐
Ka pasur kundërshtime të gjyqtarit?		
Po ☐ (nëse po duhet të pasqyrohen se cilat kanë qenë ato)		
Jo ☐		
Mendimi përfundimtar i kryetarit (Këtu Kryetari jep mendimin përfundimtar dhe përcakton shkallën e aftësisë, pas realizimit të dëgjësës me gjyqtarin)		
E dobët ☐	Mesatare ☐	E lartë ☐

2.B-b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të qenë efektiv në kryerjen e veprimeve procedurale të tilla si: vënia në lëvizje e dosjes në kohë dhe në përputhje me afatet ligjore; kryerja e veprimeve përgatitore efektive dhe në kohë, duke marrë parasysh caktimin e afateve për të metat e padisë, njoftimin e akteve apo deklaratës së mbrojtjes; planifikimi dhe zhvillimi i seancave përgatitore efektive; dokumentimi i vendimeve dhe veprimeve të tjera procedurale; drejtimi i një procesi të rregullt gjyqësor, duke orientuar drejt debatit mes palëve, duke u shprehur qartë, me urdhra dhe vendime të ndërmjetme për çdo kërkesë të tyre; fillimi i seancave pa vonesë; regjistrimi audio i seancave; ndjekja me rigorozitet e fazave në të cilat kalon shqyrtimi gjyqësor; orientimi i palëve për ndjekjen e rrugës alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, sikundër është ndërmjetësimi.

Si e vlerëson gjyqtari shkallën e aftësisë së tij?

E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐
Shpjegime				
Mendimi paraprak i kryetarit (Si e vlerëson kryetari shkallën e aftësisë së gjyqtarit në organizimin e procesit gjyqësor, bazuar në të dhëna objektive të konstatuara prej tij, pa qenë i nevojshëm hulumtimi mbi çdo dosje gjyqësore të gjyqtarit)				
E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐
Ka pasur kundërshtime të gjyqtarit?				
Po ☐ (nëse po duhet të pasqyrohen se cilat kanë qenë ato)				
Jo ☐				
Mendimi përfundimtar i kryetarit (Këtu Kryetari jep mendimin përfundimtar dhe përcakton shkallën e aftësisë, pas realizimit të dëgjësës me gjyqtarin)				
E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐

2.C Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore

2.C-a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes

Treguesi i rregullshmërisë vlerësohet në bazë të renditjes së akteve të dosjes gjyqësore në mënyrë që dosja të jetë lehtësisht e shfrytëzueshme.

Si e vlerëson gjyqtari shkallën e aftësisë së tij?

E dobët ☐

Nën mesataren ☐

Mesatare ☐

Mbi mesataren ☐

Shumë e lartë ☐

Shpjegime

2.C-b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të garantuar që dosja mos të ketë mungesa aktesh dhe që dokumentacioni i përfshirë në dosje të jetë i duburi dhe t'i përkasë çështjes konkrete.

Si e vlerëson gjyqtari shkallën e aftësisë së tij?

E dobët ☐

Nën mesataren ☐

Mesatare ☐

Mbi mesataren ☐

Shumë e lartë ☐

Shpjegime

3. Vlerësimi i etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale

Pikëzimi i këtij treguesi vlerësimi bëhet mbi bazën e parimit kushtetues që çdo gjyqtar për shkak të statusit të tij ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Procesi i vlerësimit për këtë kriter bazohet në parimin e prezumimit të pasjes së vlerave të tilla themelore në lidhje me ushtrimin e detyrës.

3.A Etika në punë

3.A-a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të shfaqur sjellje të kujdesshme, objektive, me vetëpërmbytje dhe maturi gjatë ushtrimit të detyrës, në mënyrë korrekte, të ndërgjegjshme, sistematike dhe në kohë të arsyeshme, duke shmangur në mënyrë të ndërgjegjshme dhe me vërtetësi çdo sjellje që tregon mungesë respekti, vetëpërmbytje, ndjeshmërie, vëmendjeje apo qasje të papërshtatshme dhe ofensive, duke mos u kufizuar vetën me shmangien e sjelljeve që formalisht përcaktohen si në kundërshtim me ligjin.

Si e vlerëson gjyqtari shkallën e tij të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion?

E dobët ☐

Nën mesatare ☐

Mesatare ☐

Mbi mesataren ☐

Shumë e lartë ☐

Shpjegime

Mendimi paraprak i kryetarit (Si e vlerëson kryetari shkallën e angazhimit dhe të përgjegjshmërisë në funksion të gjyqtarit?)

E dobët ☐

Nën mesataren ☐

Mesatare ☐

Mbi mesataren ☐

Shumë e lartë ☐

Ka pasur kundërshtime të gjyqtarit?

Po ☐ (nëse po duhet të pasqyrohen se cilat kanë qenë ato)

Jo ☐

Mendimi përfundimtar i kryetarit (Këtu Kryetari jep mendimin përfundimtar dhe përcakton shkallën e aftësisë, pas realizimit të dëgjësës me gjyqtarin)

E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐
----------------------------------	--	-----------------------------------	--	--

3.B Integriteti i gjyqtarit.

3.B-a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti.

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të respektuar, miratuar dhe mbështetur vlerat themelore të punës së tij, siç janë shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti; aftësia për t'iu përgjigjur pritshmërive të publikut, duke demonstruar cilësitë personale të mençurisë, ndershmërisë, ndjenjës së humanizmit, guximit, seriozitetit dhe maturisë, duke vepruar me vetëdije se sjellja profesionale, jeta private dhe sjellja e tij në shoqëri kanë ndikim në imazhin e drejtësisë dhe besimit të publikut. Gjatë marrjes së vendimeve, gjyqtarët duhet të përpiqen të shmangin të gjitha paragjykimet që mund të dëmtojnë ose të konsiderohen si të dëmshme për gjykimin e tyre. Gjyqtarët nuk duhet të tregojnë favor apo disfavor në lidhje me çështjet, palët, ose avokatët, në çështjet përpamë gjykatës. Një gjyqtar gëzon nder dhe dinjitet për publikun kur ai transmeton vlera personale dhe profesionale dhe konsiderohet një model për të tjerët.

Si e vlerëson gjyqtari aftësinë e tij për shmangien e sjelljeve të pahijshme, nderin dhe dinjitetin e tij?
(Prezumerohet se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë integriteti)

E dobët ☐	Shumë e lartë ☐
----------------------------------	--

Shpjegime

Mendimi paraprak i kryetarit (Si e vlerëson kryetari aftësinë e gjyqtarit për shmangien e sjelljeve të pahijshme, nderin dhe dinjitetin e tij?)

E dobët ☐	Shumë e lartë ☐
----------------------------------	--

Ka pasur kundërshtime të gjyqtarit?

Po ☐ (nëse po duhet të pasqyrohen se cilat kanë qenë ato)

Jo ☐

Mendimi përfundimtar i kryetarit (Këtu Kryetari jep mendimin përfundimtar dhe përcakton shkallën e aftësisë, pas realizimit të dëgjësës me gjyqtarin)

E dobët ☐	Shumë e lartë ☐
----------------------------------	--

3.C Paanësia e gjyqtarit

3.C-a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese

Me këtë tregues vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese si dhe çdo tendencë për paragjykim.

Si e vlerëson gjyqtari aftësinë e tij për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese?

E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐
----------------------------------	--	-----------------------------------	--	--

Shpjegime

3.C-b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të shfaqur paanësi në funksion. Gjyqtari bën një analizë të pavarur të të dhënave të tij statistikore dhe përzgjedh një nga nivelet e mëposhtme të vlerësimit, referuar metodologjisë së pikëzimit.

Si e vlerëson gjyqtari numrin e kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e tij?

Tejet i lartë ☐	I pakonsiderueshëm ☐
Shpjegime	
Mendimi paraprak i kryetarit (Kryetari jep mendim paraprak për këtë tregues bazuar jo vetëm në aspektin sasior, apo krabasuar me numrin total të çështjeve të gjykuara nga gjyqtari. Kryetari duhet të marrë në konsideratë numrin e kërkesave për heqje dorë të paraqitura nga gjyqtari si dhe raportin midis kërkesave për heqje dorë të miratuara me ato të refuzuara. Kryetari jep mendim për këtë tregues, pa analizuar ligjshmërinë ose besueshmërinë e vendimit të pranimit të kërkesës për përjashtim). Si e vlerëson kryetari numrin e kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit?	
Tejet i lartë ☐	I pakonsiderueshëm ☐
Ka pasur kundërshtime të gjyqtarit?	
Po ☐ (nëse po duhet të pasqyrohen se cilat kanë qenë ato)	
Jo ☐	
Mendimi përfundimtar i kryetarit (Këtu Kryetari jep mendimin përfundimtar dhe përvakton shkallën e aftësisë, pas realizimit të dëgjës me gjyqtarin)	
Tejet i lartë ☐	I pakonsiderueshëm ☐

4. Vlerësimi i aftësive personale dhe angazhimit profesional

Me anë të këtij kriteri vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit, duke vlerësuar aftësitë komunikuese, aftësinë për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e gjykatës, gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera.

4.A Aftësia e komunikimit

4.A-a Komunikimi i qartë dhe transparent

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të qenë transparent në komunikim dhe për t'u shprehur në mënyrë të kuptueshme, të qartë dhe koncize me palët ndërgjyqëse, publikun, subjektet e tjera dhe të tretët.

Si e vlerëson gjyqtari aftësinë e tij për të komunikuar qartë dhe në mënyrë transparente?

E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐
Shpjegime				
Mendimi paraprak i kryetarit (Si e vlerëson kryetari aftësinë e gjyqtarit për të komunikuar qartë dhe në mënyrë transparente?)				

E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐
Ka pasur kundërshtime të gjyqtarit?				
Po ☐ (nëse po duhet të pasqyrohen se cilat kanë qenë ato)				
Jo ☐				
Mendimi përfundimtar i kryetarit (Këtu Kryetari jep mendimin përfundimtar dhe përcakton shkallën e aftësisë, pas realizimit të dëgjësës me gjyqtarin)				
E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐

4.A-b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personal

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të treguar kujdesin maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale në lidhje me informacionet dhe të dhënat për të cilat ai vihet në dijeni për shkak të funksionit, siç mund të jenë çështjet me të mitur, ato të dhunës në familje etj.

Si e vlerëson gjyqtari aftësinë e tij në lidhje me respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale?

E dobët ☐	Mesatare ☐	E lartë ☐
Shpjegime		
Mendimi paraprak i kryetarit (Si e vlerëson kryetari aftësinë e gjyqtarit në lidhje me respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale?)		
E dobët ☐	Mesatare ☐	E lartë ☐
Ka pasur kundërshtime të gjyqtarit?		
Po ☐ (nëse po duhet të pasqyrohen se cilat kanë qenë ato)		
Jo ☐		
Mendimi përfundimtar i kryetarit (Këtu Kryetari jep mendimin përfundimtar dhe përcakton shkallën e aftësisë, pas realizimit të dëgjësës me gjyqtarin)		
E dobët ☐	Mesatare ☐	E lartë ☐

4.B Aftësia për të bashkëpunuar.

4.B-a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.

Në këtë tregues vlerësohet aftësia dhe disponibiliteti i gjyqtarit për të bashkëpunuar me kolegët pa cenuar pavarësinë e tij në vendimmarrje, angazhimi në ngritjen e problematikave mbi çështje të caktuara juridike, përmirësimet e legjislacionit, diskutimin rreth zbatimit të vendimeve njësuere, hartimin e modeleve të unifikuara të akteve procedurale, dhe çdo çështje tjetër që lidhet me veprimtarinë gjyqësore, si dhe gatishmëria për të ndarë me kolegët përvojën e përfutur në aktivitetet e

ndryshme trajnuese.

Si e vlerëson gjyqtari aftësinë e tij në lidhje me shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimin me kolegët?

E dobët ☐

Nën mesataren ☐

Mesatare ☐

Mbi mesataren ☐

Shumë e lartë ☐

Shpjegime

Mendimi paraprak i kryetarit (Si e vlerëson kryetari aftësinë e gjyqtarit në lidhje me shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimin me kolegët?)

E dobët ☐

Nën mesataren ☐

Mesatare ☐

Mbi mesataren ☐

Shumë e lartë ☐

Ka pasur kundërshtime të gjyqtarit?

Po ☐ (nëse po dubet të pasqyrohen se cilat kanë qenë ato)

Jo ☐

Mendimi përfundimtar i kryetarit (Këtu Kryetari jep mendimin përfundimtar dhe përcakton shkallën e aftësisë, pas realizimit të dëgjësës me gjyqtarin)

E dobët ☐

Nën mesataren ☐

Mesatare ☐

Mbi mesataren ☐

Shumë e lartë ☐

4.B-b Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të ndërvëpruar rregullisht me personelin e gjykatës, nxitja e marrëdhënieve bashkëpunuese me qëllim krijimin e një ambienti pune harmonik dhe produktiv.

Si e vlerëson gjyqtari aftësinë e tij në lidhje me komunikimin dhe bashkëpunimin me administratën gjyqësore?

E dobët ☐

Nën mesataren ☐

Mesatare ☐

Mbi mesataren ☐

Shumë e lartë ☐

Shpjegime

Mendimi paraprak i kryetarit (Si e vlerëson kryetari aftësinë e gjyqtarit në lidhje me komunikimin dhe bashkëpunimin me administratën gjyqësore? Cila është shkalla e këtij komunikimi?)

E dobët ☐

Nën mesataren ☐

Mesatare ☐

Mbi mesataren ☐

Shumë e lartë ☐

Ka pasur kundërshtime të gjyqtarit?

Po ☐ (nëse po dubet të pasqyrohen se cilat kanë qenë ato)

Jo ☐

Mendimi përfundimtar i kryetarit (Këtu Kryetari jep mendimin përfundimtar dhe përcakton shkallën e aftësisë, pas realizimit të dëgjësës me gjyqtarin)

E dobët ☐

Nën mesataren ☐

Mesatare ☐

Mbi mesataren ☐

Shumë e lartë ☐

4.C Gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjer.

4.C-a Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.

Me këtë tregues vlerësohet angazhimi i gjyqtarit në programin e trajnimit vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës, si dhe në aktivitete të tjera trajnuese jashtë këtij programi, me qëllim ngritjen profesionale të gjyqtarit.

A e ka përmbushur gjyqtari detyrimin ligjor mbi pjesëmarrjen në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale, gjatë periudhës së vlerësimit?

Po ☐

Jo ☐

Shpjegime (Këtu gjyqtari duhet të përcaktojë pjesëmarrjen në aktivitete trajnuese të zhvilluar jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, duke specifikuar përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e trajnimit, si dhe të dhëna për institucionin që ka organizuar aktivitetin. Dokumentacionin përkatës ia bashkëlidh formularit).

4.C-b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.

Me këtë tregues vlerësohet gatishmëria dhe shfaqja e vullnetit të gjyqtarit pranë organeve përkatëse me qëllim përfshirjen në listat e gjyqtarëve udhëheqës në praktikën profesionale të kandidatëve për gjyqtarë, dhe/ose si ekspert/lehtësues në trajnimin fillestar apo vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, apo në trajnime të organizuara nga institucione të tjera.

Shpjegime (Gjyqtari duhet të listojë këtu informacione mbi pjesëmarrjen dhe/ose përfshirjen në veprimtaritë trajnuese në të cilat është angazhuar).

4.C-c Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstytucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Me këtë tregues vlerësohet aftësia dhe gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari për të përmirësuar sistemin gjyqësor, veprimtari jashtë funksionit, me ose pa pagesë, të tilla si: fjalime publike; prezantime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; pjesëmarrja në programet e edukimit të komunitetit; bashkëpunimi me Këshillin për përmirësimin e programeve të formimit vazhdues; angazhimi si ekspert në punët e Këshillit për përgatitjen e formave standarde me qëllim rritjen e eficiencës; kontribute në hartimin e legjislacionit; aktivitete mësimdhënëse për çështje ligjore; bashkëpunimi me grupe interesash të ndryshëm me qëllim rritjen e cilësisë së gjyqësorit dhe ndërgjegjësimin e publikut për forcën e zbatimit të ligjit, si edhe çdo veprimtari tjetër e ngjashme në fushën juridike.

Shpjegime (Gjyqtari duhet të listojë këtu informacione mbi pjesëmarrjen dhe/ose përfshirjen në veprimtari ndërinstytucionale si më sipër. Dokumentacionin përkatës ia bashkëlidh formularit.)

Mendimi paraprak i kryetarit (Kryetari jep mendim paraprak për këtë tregues në rastet kur ai është në detyrë të angazhimit të gjyqtarit, apo kur ky angazhim ka qenë i inicuar nga vetë kryetari i Gjykatës)

Ka pasur kundërshtime të gjyqtarit?

Po ☐ (nëse po duhet të pasqyrohen se cilat kanë qenë ato)

Jo ☐

Mendimi përfundimtar i kryetarit (Këtu Kryetari jep mendimin përfundimtar dhe përcakton shkallën e aftësisë, pas realizimit të dëgjësës me gjyqtarin)

4.C-ç Publikime ligjore akademike

Me anë të këtij treguesi vlerësohet angazhimi i gjyqtarit në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike me qëllim dhënien e kontributit për zhvillimin e doktrinë, të tilla si: artikuj, kapituj, monografi ose publikime shkencore të tjera, të botuara brenda dhe jashtë vendit, të shoqëruara me numër identifikimi (ISBN, ISSN).

Shpjegime (Gjyqtari duhet të listojë këtu informacione mbi publikimet ligjore akademike të tij gjatë periudhës së vlerësimit. Dokumentacionin përkatës ia bashkëlidh formularit)

Në referim të nenit 86, pika 1, shkronjat “c”, “ç”, “d”, “dh” të ligjit për statusin, gjyqtari jep mendim për sa më poshtë:

a) Masat e ndërmarra për përmbushjen e objektivave të përcaktuar në vlerësimin e mëparshëm dhe shkalla e përmbushjes së tyre.

Shpjegime

b) Objektivat për zhvillimin e tij profesional për vlerësimin e ardhshëm.

Shpjegime

c) Nevojat për trajnim dhe rrethanat të cilat përbëjnë pengesë për zhvillimin e tij profesional duke propozuar zgjidhje konkrete për periudhën e ardhshme të vlerësimit.

Shpjegime

Në referim të nenit 86, pika 2, të ligjit për statusin, gjyqtari i bashkëlidh formularit të vetëvlerësimit dy vendime gjyqësore të përzgjedhura prej tij, për çdo vit të periudhës së vlerësimit.

a) Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari.

Vendimet e përzgjedhura listohen në këtë rubrikë dhe i bashkëlidhen formularit të vlerësimit.

Për t'u plotësuar nga gjyqtari

Plotësuar nga: **Emër:** **Mbiemër:** **Nënshkrimi:**

Dorëzuar te Kryetari më datë:

Marrë në dorëzim nga: **Emër:** **Mbiemër:** **Nënshkrimi:**

Për t'u plotësuar nga kryetari

Plotësuar nga: **Emër:** **Mbiemër:**

Nënshkrimi: